



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova
Komuna e Novobërdës
Opština Novo Brdo - Municipality of Novo Brdo



KUVENDI KOMUNAL-SKUPŠTINA OPŠTINE- MUNICIPAL ASSEMBLY

Anëtarit të Komitetit për Politikë dhe Financa
Z/znj _____

Në bazë të dispozitave të nenit 52 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale si dhe në bazë të dispozitave të nenit 41 të Statutit të Komunës së Novobërdës.

Mbledhjen e gjashtë të Kuvendit komunal e cila do të mbahet më: **28.06.2024** (E premje) duke filluar në ora **10:00**.

Rendi i ditës

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KK-së;
2. Aprovimi e Kornizes Afatmesme Buxhetore 2025-27;
3. Bartja e mjeteve të investimeve kapitale;
4. Raporti i Drejtorisë mbi pregaditjen për sezonin e korrje - shirjeveve 2024;
5. Diskutim rreth gjendjes dhe mbrojtjes së ambientit në territorin komunës së Novobërdës;
6. Të ndryshme;


Mbledhja do të mbahet në hapësirat e K.K-së në Novobërdë.

Më:19.06.2024
Në: Novobërdë

Kryesuese e Kuvendit
Mirjana Simijonović



Mbledhja do të mbahet në hapësirat e K.K-së në Novobërdë.



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosova
Komuna e Novobërdës
Opština Novo Brdo–Municipality of Novo Brdo

ZYRA E KUVENDIT/KANCELARIJA SKUPŠTINE

PROCESVERBAL

Procesverbali i Kuvendit

Nga mbledhja e pestë e Kuvendit të Komunës së Novobërdës e mbajtur më datë 31.05.2024, duke filluar në orën 10:00.

Në mbledhje kanë marrë pjesë: Kryesuesja e Kuvendit znj.Mirjana Simijonovic, zv.kryesuesi i kuvendit zt.Ramush Mehmeti, antarët e Kuvendit: Stojan Stanojevic, Dragana Dimic, Pranvera Kastrati Gashi, Negovan Jovanovic, Milica Jovanovic, Selatin Nuhiu, Dobrivoje Djordjevic, Abdyl Gashi, Vlora Vllasaliu, Stefan Kovacevic, Violeta Milosevic, Dragana Dimic, Ivica Cenic, ZKF Zoran Cvetkovic, Zyrtari për bujqësi Avdi Vllasaliu, përfaqësuesi i OSBE-së, zyrtarë komunal dhe qytetarë.

Kryesuesja e Kuvendit pasi pershendeti të pranishmit tha: konstatoj korumin prezent janë të gjithë antarët e Kuvendit, kemi korum për punë dhe vendimarrje dhe po fillojm mbledhjen me këtë:

ZYRA E KUVENDIT/KANCELARIJA SKUPŠTINE
R e n d i t e

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e K.K-së;
2. Informat mbi qarkoren e parë Buxhetore të Ministrisë së Financave;
3. Bartja e mjeteve të investimeve kapitale;
4. Raportim nga Drejtoria e Bujqësisë rreth mbjelljeve pranverore;
5. Planifikimi dhe mbajtja e takimeve të Kuvendit me qytetarët e Komunës së Novobërdës për propozim buxhetin e vitit 2025/27;
6. Të ndryshme;

Kryesuesja tha: a keni ndonjë propozim për rend të dites?

Stojan Stanojevic pasi pershendeti të pranishmit tha: pasi nuk është askush prezent nga drejtoria e bujqësisë kerkoj që kjo pikë të tërhiqet.

Kryesuesja tha: mundë të vin në ndërkohë, nese nuk vin atëher e terheqim. Unë e kam një propozim për rend të dites besoj që e keni marrë materialin në email, bëhet fjalë për fshatin Koretisht pasi që funksionojn dy shkolla dhe ka një numer të madhë të nxënësve është e nevojshme të ndërtohet një sall sportive dhe për këtë nevojitet pelqimi nga Kuvendi.

Kryesuesja e hapi diskutimin rreth këtij propozimi.

Abdyl Gashi pasi pershendeti të pranishmit tha: është një kërkes nga një bashkëvendas i imi por nese ka mundësi të del si pikë e parë pasi që nuk po kam mundësi të rri deri në fund të mbledhjes.

Kryesuesja tha: këto pika gjithmonë kanë qenë te pika të ndryshme.

Kryesuesja i pyeti antarët e Kuvendit se kush është për propozimin e saj që të hy në rend të dites?

6. Të ndryshme;

Kryesuesja tha: a keni ndonjë propozim për rend të dites?

Stojan Stanojevic pasi pershendeti të pranishmit tha: pasi nuk është askush prezent nga drejtoria e bujqësisë kerkoj që kjo pikë të tërhiqet.

Kryesuesja tha: mundë të vin në ndërkohë, nese nuk vin atëher e terheqim. Unë e kam një propozim për rend të dites besoj që e kam marrë materialin në email, bëhet fjalë për fshatin Koretisht pasi që funksionojn dy shkolla dhe ka një numer të madhë të nxënësve është e nevojshme të ndërtohet një sall sportive dhe për këtë nevojitet pelqimi nga Kuvendi.

Procesverbali i Kuvendit

Aprovohet njëzëri propozimi që të ipet pelqimi nga Kuvendi për ndertimin e sallës sportive në parcelën me numër Q2704-0 e cila është në pronësi të Komunës së Novobërdës.

Kryesuesja i pyeti antarët për aprovimin e rendit të ditës

Aprovohet njëzëri rendi i ditës nga të gjithë antarët prezent të Kuvendit.

Pika e parë: Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e K.K;

Kryesuesja e hapi diskutimin për këtë pikë.

Pasi nuk pati vërejtje procesverbali u aprovua njëzëri nga antarët prezent të Kuvendit.

Pika e dytë: Informat mbi qarkoren e parë Buxhetore të Ministrisë së Financave;

Për këtë pikë Kryesuesja ja kaloi fjalën ZKF.

Zoran Cvetkovic pasi pershendeti të pranishmit tha: materialin e keni marrë me kohë, ky është propozimi numer 1 i qarkores buxhetore pas propozimeve do të jetë edhe propozimi numer 2. Në formë tabelare janë të treguara shumat, buxheti na është rritur për 350,000€, për 90,000€ është rritur granti i pergjithshem Në vitin e kaluar ka qenë mbi 1,640,000€ në këtë vit është mbi 1,700,000€. për vitin e ardhshëm sipas informatave në këtë qarkore buxhetore buxheti do të jetë mbi 4,300,000.00€ Edhe granti i arsimit është rritur, në vazhdim të tabelat shihni se cilat mjete shpenzohen për paga dhe medijtje, cilat për mallra dhe sherbime. Për vitin 2024 Ministria e ka paraparë nga të hyrat vetanake dashur ti realizojmë 313,000€, por në vitin e kaluar kemi pasur mbi 400,000€ të hyra por si duket Ministria në bazë të realizimit të vitit të kaluar na ka rritur realizimin e të hyrave për vitin 2025 në 4,500,000€, këto janë në propozimin numer 1. Kemi zvoglim të puntorëve, pasi që puntorët në Drejtorin e Bujqësisë rojet e pyjeve kanë kaluar me agjension të pyjeve, edhe puntorët e kadastrit do të barten me agjension kadastral.

Kryesuesja e hapi diskutimin për këtë pikë.

Pasi nuk pati diskutime Kryesuesja kaloi në piken e radhes

Pika e tretë: Bartja e mjeteve të investimeve kapitale;

Kryesuesja për këtë pikë ja kaloi fjalën ZKF-së.

Zoran Cvetkovic tha: edhe në KPF ju kam njoftuar që bartja është në shumë prej 89,474€ dhe bëhet fjalë për projektet që i kemi parashiku për vitin e kaluar që ti realizojmë, zyrja e prokurimit ka arritur ti procesoj ose projekttoj një numer të atyre projekteve por nuk i kanë përmbyllur të gjitha projektet e vitit të kaluar andaj ne kemi menduar që ti shfrytëzojmë këto mjete për pjesen e atyre projekteve që janë në përfundim e siper. Ne kemi shpenzuar 21,000€ dhe kanë mbetur ende mjete të lira, por ju kisha lutur që këtë pikë ta shtym për mbledhjen e ardhshme pasi që zyrja e prokurimit ti përfundoj të gjitha procedurat dhe obligimet që i kemi dhe shumen e sakt se sa duhet bartur do ta kemi në fund të muajit, andaj që mos të biem në situat që mos ti paguajm të gjitha projektet.

Kryesuesja konstatoi se të pranishem janë 14 antarë prezent në Kuvend.

Me 14 vota për aprovohet kjo pikë që të shtyhet për mbledhjen e ardhshme.

Pika e katërt: Raportim nga Drejtoria e Bujqësisë rreth mbjelljeve pranverore;

Kryesuesja për këtë pikë ja kaloi fjalën Zyrtarit për bujqësi.

Avdi Vllasaliu pasi pershendeti të pranishmit tha: unë materialin nuk kam arrit me dergu pasi që nuk kam arrit me perkthi. Unë do t'ju raportoj për mbjelljet pranverore dhe vjeshtore, grur i kemi të mbjellura 684.82ha me 283 fermer, me elb 73.36ari me 60 fermer, me tersher 68.61 ari me 40fermer, me theker 34 ari me 13 fermer, me miser 266,47ha me 185 fermer, me lop qumështore 843 krerë me 78 fermer, me dele 1267 cop me 15 fermer, me dhi 543 cop me 15 fermer, me bletë 2743 shoqëri me 57 fermer, me bletë kemi rritje, edhe te fermereve edhe të numrit të koshereve, kaq nga unë nese keni ndonjë pyetje urdhëroni?.

Kryesuesja tha: kishte qenë më mirë që të jete numri edhe më i madhë i fermereve, por e kam një pyetje sa i perket ndarjes së subvencioneve ankesat a duhet të bëhen të ju?.

Avdi Vllasaliu tha: Kryetari e ka formuar komisionin për ankesa.

Kryesuesja tha: a ka kohë ende për ankesë?.

Avdi Vllasaliu tha: nuk besoj pasi që kanë përfunduar procedurat.

Kryesuesja konstatoi se të pranishem janë 14 antarë prezent në Kuvend.

Me 14 vota për aprovohet kjo pikë që të shtyhet për mbledhjen e ardhshme.

Pika e katërt: Raportim nga Drejtoria e Bujqësisë rreth mbjelljeve pranverore;

Kryesuesja për këtë pikë ja kaloi fjalën Zyrtarit për bujqësi.

Avdi Vllasaliu pasi pershendeti të pranishmit tha: unë materialin nuk kam arrit me dergu pasi që nuk kam arrit me perkthi. Unë do t'ju raportoj për mbjelljet pranverore dhe vjeshtore, grur i kemi të mbjellura 684.82ha me 283 fermer, me elb 73.36ari me 60 fermer, me tersher 68.61 ari me 40fermer, me theker 34 ari me 13 fermer, me miser 266,47ha me 185 fermer, me lop qumështore 843 krerë me 78 fermer, me dele 1267 cop me 15 fermer, me dhi 543 cop me 15 fermer, me bletë 2743 shoqëri me 57 fermer, me bletë kemi rritje.

• Procesverbali i Kuvendit

Stojan Sanojevic pasi pershendeti të pranishmit tha: shumë raport i mirë, drithërat janë në rritje sidomos gruri që është normal por me brengos fakti se kafshët janë në zvoglim ndoshta duhet të rrisim numrin duke i ndihmuar. U përmend edhe ndarja e mjeteve bujqësore por disa gjëra mos ti keqkuptojmë personalisht, pasi ne si organ ligjvënës duhet që të gjitha vendimet të kalojnë përmes kuvendit, nese njëher është formuar komisioni dhe tani po formohet komision tjetër, nese është ashtu duhet të respektohen edhe antarët e Kuvendit, edhe një pyetje e kam se ka limite për cilin mjet bujqësor mundë të aplikoj qytetari, p.sh a kemi raste kur bujku aplikon për një mjete a deri në çfarë shume.

Avdi Vllasaliu tha: deri në 1,000€ ka qenë vlera e aplikimit për një mekanizem ndërsa tani është deri në 1200 ose 1300, shumën prej 30% e pagun fermeri në varet se çfarë mjeti është pasi që tash të gjitha janë më shtrejt.

Ramush Mehmeti pasi pershendeti të pranishmit tha: Kuvendi nuk ka të drejt të formoj komision për menaxhimin e ekzekutivit, kuvendi ka të drejt të formoj komision për dhënje të pronave në shfrytëzim dhe të njëjtin komision mundë të ketë ankesa nga qytetarët. Kryetari kur ka qenë në një mbledhje ka thënë vet se lista e përfituesve të makinave bujqësore do të vij në Kuvend, ne e kemi votu buxhetin për makina bujqësore dhe si Kuvend nuk mundë të perzihemi më teper, forma ma e mirë dhe më transparente kishe me qenë me ardh lista në Kuvend.

Stojan Sanojevic tha: mos me keqkupto por është formuar komisioni për shqyrtimin e ankesave të qytetarëve dhe ne kemi harruar që dy vite se kush na ka votuar ne dhe për kënd ne jemi këtu dhe besoj se çdo qytetarë ka të drejt ankesa dhe nuk është fer ndaj qytetarëve.

Kryesuesja tha: komisionet obligative që janë nga Kuvendi janë formuar si komisioni për dhenje të pronave në shfrytëzim dhe komisioni për pranimin e ankesave nese komisioni diçka ankohet që nuk ka qenë diçka në rregull pra nese ka ndonjë shkelje. Edhe Pranvera kur ka qenë drejtori kemi kërkuar listen e përfituesve të këtyre mjeteve bujqësore dhe ne kemi të drejt ta kërkojm atë listë por na kanë thënë se lista nuk është e përfunduar për arsye të ankesave të qytetarëve, si ta dien qytetarët se kush ka përfituar e kush jo. Ne të gjithë jemi këtu që ti mbrojm interesat e qytetarëve.

Avdi Vllasaliu tha: afati për ankesa ka qenë 30 ditë, listen e fermereve që kanë përfituar do ta sjellim në Kuvend, një list që e ka sjell drejtori nga Ministria e Bujqësisë atë list nuk është dashur të sjell për arsye se janë mjete nga Ministria dhe ne aty nuk kemi të drejt as të perzihemi e as të japim llogari.

Dobrivoje Djordjevic pasi pershendeti të pranishmit tha: hera e parë që pajtohem me Kryesuesen pasi që nuk është transparente dhe si është e mundur që dikush të ankohet nese e keni dhënë afatin për ankes por se keni definuar listen, ka fermer që për heren e pestë po marrin panderper ndërsa me rregullore nuk ka të drejt ta aplikoj dikush që ka përfituar deri në tre vitet e fundit.

Avdi Vllasaliu tha: as unë nuk jam që të përfitojnë të gjithë, tre persona kanë përfituar me një traktor, si po ankohen po përfitojnë, nuk duhet të ketë kosmosn të dytë

Kryesuesja tha: dje i keni shpernda mjetet e kur kanë ardh me i marrë i kanë thënë se nuk je në listë, ndërsa më herët i kanë thënë se i plotëson kushtet ndërsa tani ka përfunduar afati i ankesave e ku të ankohet më ai, dikush ska përfituar asnjëherë e dikush çdo vitë.

Selatin Nuhiu pasi pershendeti të pranishmit tha: po më vjen keq që po mirremi me këtë zyrtarin pasi që më mirë kishte me qenë që të jetë Drejtori prezent por siç po shihet mjetet bujqësore duhet të ndahen në bazë të kriterëve por si çdo herë janë bërë pazare këtu, e diem që janë kanë edhe në zyre të partive politike listat e shperndarjes dhe mendoj se kjo duhet të ndalet por po e shohim edhe këtë vit se nuk ka ndodhë ashtu, kur të jenë kriteret të jenë kriteret për të gjithë.

Ramush Mehmeti tha: fajtor jemi edhe ne si antarë të kuvendit pasi që kur janë caktuar kriteret ne është dashur që ti votojm në Kuvend, unë vet jam fermer kam mbjell 1 hekta kep, kam mbjell miser, 1 hektar e 70 ari tersher dhe kurr nuk kam aplikuar dhe as nuk do të aplikoj asnjëherë.

Kryesuesja tha: në dy mbledhjet e kaluar Pranvera ka kërkuar listen, prandaj për vitin e ardhshëm deri sa të vij te shperndarja e mjeteve Kuvendi ti votoj kriteret.

Avdi Vllasaliu tha: as unë nuk jam që të përfitojnë të gjithë, tre persona kanë përfituar me një traktor, si po ankohen po përfitojnë, nuk duhet të ketë kosmosn të dytë

Kryesuesja tha: dje i keni shpernda mjetet e kur kanë ardh me i marrë i kanë thënë se nuk je në listë, ndërsa më herët i kanë thënë se i plotëson kushtet ndërsa tani ka përfunduar afati i ankesave e ku të ankohet më ai, dikush ska përfituar asnjëherë e dikush çdo vitë.

Selatin Nuhiu pasi pershendeti të pranishmit tha: po më vjen keq që po mirremi me këtë zyrtarin pasi që më mirë kishte me qenë që të jetë Drejtori prezent por siç po shihet mjetet bujqësore duhet të ndahen në bazë të kriterëve por si çdo herë janë bërë pazare këtu, e diem që janë kanë edhe në zyre të partive politike listat e shperndarjes dhe mendoj se kjo duhet të ndalet por po e shohim edhe këtë vit se nuk ka ndodhë

Procesverbali i Kuvendit

Pranvera Kastrati Gashi pasi pershendeti të pranishmit tha: sa i perket listave është shumë lehtë për mos me ardh drejtorat në kuvend, veç ja u kerkojm një list dhe më nuk vin. Shumë e listat i kam kërkuar dhe nuk i kanë sjell por nuk e di a e din që Drejtorët nese nuk i sjellin listat, unë kam të drejt me bë kërkes më shkrim por nese përseri nuk pergjigjen nuk e di a e din antarët e Kuvendit por është komisioni në Prishtinë ku deri në 5,000€ është denimi për drejtora që nuk sjellin listen që kërkon antari i kuvendit. Sa i perket zt.Ramush e permendi që ka shumë toka të mjellura por nuk ka marrë mjete, por unë e di që ke marrë vitin e kaluar ndoshta në emer të fëmijeve por ke marrë. Por unë njoh që i punon 6 hektar tokë ka aplikuar vitin e kaluar por nuk ka përfituar është kunati jem që ska përfituar, ndërsa ka çdo vit që përfitojn dhe i shesin në Llabjan dhe Shillov nuk është në rregull. Unë listen e kerkoj edhe me shkrim.

Avdi Vllasaliu tha: sa i perket kriterëve që janë nga Drejtoria kanë qenë gjithmonë dhe janë që nese ke prifituar këtë vit, 3 vite ske të drejtë të aplikoj, pse nuk po thu që ka përfituar Bedria por po e cek vetem atë që ska marrë.

Ramush Mehmeti tha: kur është puna për buxhet për çdo gjë kemi të drejt të kërkojm raporte, por nuk ka të drejt me pru raporte të subvendcioneve nga Ministria e Bujqësisë pasi që ato janë subvencione nga Ministria, po ju pergjigjem Pranveres pasi që as një lopat familja e Ramush Mehmetit nuk e ka marrë, kam marrë subvencione nga Ministria e Bujqësisë ndërsa në Komunës as nuk kam aplikuar.

Kryesuesja tha: pauz 5min.

Pika e pestë: Planifikimi dhe mbajtja e takimeve të Kuvendit me qytetarët e Komunës së Novobërdës për propozim buxhetin e vitit 2025/27;

Kryesuesja tha: do të mbajmë një takim në sall të Kuvendit për buxhet por pasi që nuk mundë të vin prej të gjitha fshatrave mendoj se është më mirë që të organizojm disa takime në disa fshatra në mënyrë që ti informojmë të gjithë qytetarët besoj se pajtoheni edhe ju që të mbajme një takim në Llabjan, një në Stanishor, në Pasjak, Koretishtë, pasi që siç na njoftoi drejtoria e financave vetem një takim e kemi për obligim që ta mbajmë.

Kryesuesja e hapi diskutimin për këtë pikë.

Stojan Stanojevic tha: shumë pikë me vend pasi që nuk mundë të vin të gjithë qytetarët këtu dhe ne smund të ju ndihmojmë të gjithë qytetarëve.

Kryesuesja tha: ne do të pregadisim një planë dhe në bazë të atij plani do të mbajmë takimet.

Pika e gjashtë: Pajtueshmeria për dhënje të parcellës për ndertimin e sallës në Koretishtë;

Kryesuesja tha: duke pas parasysh se në fshatin Koretishtë funksionojnë dy shkolla, ajo fillore dhe e mesme ekonomike, të cilat i frekuentojnë një numër i caktuar nxënësish, më saktë 157 nxënës në të dyja shkollat së bashku, dhe për këtë është e nevojshme të ndërtohet një sallë sportive e cila do të përdorej për nevojat e këtyre shkollave, por edhe në vende të tjera në Novobërdë. Mjete për ndertimin e sallës janë siguruar nga qytetarët e fshatit Koretishtë si dhe nga fshatrat përreth në Komunën e Novobërdës. Është e nevojshme të miratohet pelqimi për ndertimin e sallës së përmendur sportive në parcelën me numër 02704-0, e cila është në pronësi të Komunës së Novobërdës.

Kryesuesja e hapi diskutimin për këtë pikë.

Pranvera Kastrati Gashi tha: pajtohem se kjo është në të mirën e qytetarëve sidomos të nxënësve pasi që ka 157 nxënës por është i mangët dokumentacioni pasi që mungon fleta poseduese e keni cek vetem numrin e parcelës.

Kryesuesja tha: këtu po kërkohet vetem një pajtueshmeri, para se të fillohet me punën do ta kemi komplet proejktin se si do të realizohet.

Kryesuesja konstato se në sall janë prezent 13 antarë të kuvendit.

Kryesuesja hapi diskutimin për këtë pikë.

• Procesverbali i Kuvendit

Pasi nuk pati tjera diskutime me 13vota për aprovohet kjo pikë dhe mirret ky:

VENDIM

Aprovohet,Kërkesa e Kryetarit të Komunës për dhënjen e pelqimit për ndertimin e objektit të salles së sportit për nevojat e shkollave, Shkolles fillore dhe Shkolles së Mesme Ekonomike në f.Sh.Koretisht.

Pika e shtatë: të ndryshme;

Kryesuesja tha: e kemi një kërkesa nga një qytetar ku kërkon një pjesë të rruges nga Komuna ndërsa një pjesë të rruges së vet ja dhuron Komunës, pronë e Komunës është 305m ndërsa qytetari i dhuron 510m që i bjen se 200m i përfitojm më teper, e kemi dokumentacionon e kompletuar.

Kryesuesja e hapi diskutimin për këtë pikë.

Pranvera Kastrati Gashi tha: përseri nuk kemi dokumentacion për këtë rrugë, ndoshta e kan drejtoria por ne nuk kemi kurfar dokumentacioni për rrugë si asnjëher nuk kemi pasur as më herët pikërishtë për këtë shumë herë nuk kam votuar, si me e dit ne se çfarë rruge po e redistinojmë.

Kryesusja tha: është gabim i administrates së Kuvendit që nuk i ka derguar tek ju materialin, unë e kam të gjithë të kompletuar, antarët e kuvendi kanë të drejt ta dien atë që do ta votojnë.

Ramush Mehmeti tha: ne dy raste i kemi pasur që i kemi votuar dhe asnjëherë nuk kanë marrë mterial anatrët e Kuvendit, mjafton me ardh pelqimi i drejtorisë së është në pajtim me ligjin kërkesa. Nuk është fer që të shqyhet pasi që dokumentacioni është i kompletuar dhe qytetari e ka pronën në shitje, ka qenë edhe në mbledhjen e kaluar.

Selatin Nuhiu tha: kryesuese kërkoj nga ti mirëkuptim dhe nga antarët e kuvendit edhe pse nuk e kemi materialin përpara ju kisha lut që ta votoni këtë pikë pasi që qytetari është që 2-3muaj duke ardhë për këtë qështje si dhe është që 2 orë duke pritur, ta votojm këtë pikë si e votum për sallën në Koretishtë as aty nuk patem fletë poseduese.

Pranvera Kastrati Gashi tha: nuk e kërkoja Cd vetem e kërkoja fleten poseduese, më shumë respekt për personin që është prezent, zt Ramushi e ceki disa herë që kemi votuar ridestinin të pronave, unë asnjëherë të vetme nuk e kam votuar, nuk thash për mos me u votu kjo pikë.

Dobrivoje Djordjevic tha: unë i vetmi kam qenë kunder këtyre redistinimeve të pronave.

Stojan Stojanovic tha: çdo kush ka të drejten e mendimit të vet por pasi që nuk ka ardhur si pikë e rregullt edhe materialin administrata nuk e ka derguar dhe ju nuk e keni ditur.

Kryesuesja tha: ne jemi të obliguar që çdo material që ne e kemi të ju dergojm edhe juve, nuk e di se si administrata e ka lëshuar këtë, është plotësim i rendit të ditës dhe pasi që ju nuk e keni materialin nuk mundë të kërkoj nga ju që ta votoni, por në të ardhmen çdo material do ta verifikoj se a e keni marrë edhe ju apo jo.

Stojan Stanojevic tha: ju keni votuar që kjo pikë të jetë në Kuvend si plotësim i rendit të ditës .

Ramush Mehmeti tha: kërkoj mirëkuptim për hirë të asaj që çdo herë kemi votuar unanim për hirë të situates ta votojm.

Selatin Nuhiu tha: pasi që ju e keni materialin të keni konsiderat, ndoshta edhe ty po të bjen shumë me kry punen e drejtorit të kryetarit e të administartes, më mirë kishte qenë mirë që të ishte drejtori këtu, ne kemi votuar edhe më herët pa e pasur materialin.

Pasi nuk pati tjera diskutime me 11vota për, 2 nuk kan votuar aprovohet kjo kërkesë e qytetarit dhe mirret ky:

VENDIM

APROVOHET kërkesa e Drejtorisë së Kadastrit për ndryshim të Rruges sipas ligjit nr. 04/L-144, neni 11, pika 1,rrugë e cila është në pronë private në parcelat nr. P-72414040-00039-1 në zonen Kadastrale Llabjan e cila është më pronësi të zt.Abazi Ragip (SABIT),me siperfaqe prej:551m 2 ,kalon në Emri e Kuvendit Komunal të Novobërdës,si në bazë të drafti i pregaditur nga ana e gjeodetit të licencuar Msc.Valon Azizi.

5

Stojan Stanojevic tha: ju keni votuar që kjo pikë të jetë në Kuvend si plotësim i rendit të ditës .

Ramush Mehmeti tha: kërkoj mirëkuptim për hirë të asaj që çdo herë kemi votuar unanim për hirë të situates ta votojm.

Selatin Nuhiu tha: pasi që ju e keni materialin të keni konsiderat, ndoshta edhe ty po të bjen shumë me kry punen e drejtorit të kryetarit e të administartes, më mirë kishte qenë mirë që të ishte drejtori këtu, ne kemi votuar edhe më herët pa e pasur materialin.

Pasi nuk pati tjera diskutime me 11vota për, 2 nuk kan votuar aprovohet kjo kërkesë e qytetarit dhe mirret

• **Procesverbali i Kuvendit**

Ndersa praela me numer te parceles,00019-0 Zone kadastrale Llabjan (ishë rruga për fshatin Brus)me sipërfaqe prej:320m2,kalon në emrin e Abazi Ragip (SABIT).

Stojan Stanojevic tha: kryesuese dhe zv.kryesuese po ju drejtohem juve pasi që ne ndaj neve si kuvend po janë shumë jo serioza pasi që ne po i kerkojm disa gjëra por spo vin drejtorat kerkoj nga ju që të bisedoni me Kryetarin, si dhe ne kemi marrë një vendim për blerjen e laptopave çka ka ndodhë me atë vendim?.

Kryesuesja tha: për laptop ne i kemi dorëzuar një kërkesë por është e pamundur që të realizohet për të gjithë pasi që nuk ka buxhet mirëpo do të mundohemi që për këtë vit ta mbulojm një pjesë të administrates e më pastaj do të shikojm për pjesen tjetër të Kuvendit.

Pasi nuk pati diskutime tjera Kryesuesja i falenderoi të pranishmit për pjesëmarrje.

Mbledhja përfundoi në ora 11:55.

Procesverbali i Kuvendit

Ndersa praela me numer te parceles,00019-0 Zone kadastrale Llabjan (ishë rruga për fshatin Brus)me sipërfaqe prej:320m2,kalon në emrin e Abazi Ragip (SABIT).

Valmire Mustafa

Procesmbajtëse

Valmire Mustafa

Mirjana Simijonovic

Kryesuese e Kuvendit



Pasi nuk pati diskutime tjera Kryesuesja i falenderoi të pranishmit për pjesëmarrje.

Mbledhja përfundoi në ora 11:55.

Valmire Mustafa

Procesmbajtëse

Mirjana Simijonovic

Kryesuese e Kuvendit